



Datë: 07.07.2025
Numër Protokolli: 4655/2025

A.nr.929/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi- Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 929/2025 të datës 21.05.2025, të parashtruar nga ankuesja Sh.K-I, kundër organit të punësimit; Thesari i Kosovës, në çështjen juridik “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës , i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.07.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa numër A.nr. 929/2025 e datës 21.05.2025, e parashtruar nga ankuesja Sh.K-I.

A r s y e t i m

Ankuesja Sh.K-I (me tej referuar vetëm ankuesja), më datë 21.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.929/2025, me pretendimet ankimore lidhur me konkursin RN00017348, të datës 24.03.2025, për Grup i Buxhetit dhe Financave, për pozitën “ Zyrtar i Lartë i Listës së Pagave” Profesionale 1, të zhvilluar nga Thesari i Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Thesari i Kosovës, ndërsa kjo e fundit, më datë 29.05.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova: Ankesën A.nr. 3377/2025 të datës 21.05.2025; drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e Letërnjoftimit për ankuesen; Njoftimi me numër protokolli 363 i datës 06.05.2025, i nxjerr nga Burimet Njerëzore të Thesarit të Kosovës; Kërkesën për përgjigjeje në ankesë e datës 28.05.2025, e dërguar përmes emailit nga A.B, për S.; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 929/2025, e datës 29.05.2025; Konkursin me numër referencë RN00017348, i datës 24.03.2025; Lista e aplikantëve; Aplikacioni i SH.K, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 3704,

e datës 05.11.2013, për Sh.k, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës ‘‘Hasan Prishtina’’; Diplomë me numër protokolli 2216, e datës 04.03.2020, për Sh.k, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës ‘‘Hasan Prishtina’’; Certifikatat e ankueses Sh.K; Pasqyra e trustit për periudhën nga data 01.08.2002, deri me datën 04.11.2024; Kontrata e punës e datës 01.01.2024, për Sh.K; Vërtetim i datës 03.08.2012, për Sh,k; Njoftimi me numër protokolli 429 i datës 27.05.2025, i Burimeve Njerëzore i Thesarit të Kosovës; Renditja përfundimtare e kandidateve, e datës 26.05.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së ankesa e ankueses është e palejuar, **sepse**:

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Thesari i Kosovës më datë 24.03.2025, ka shpallur konkursin me numër reference RN00017348 për emrin e grupit ‘‘Grupi i Buxhetit dhe Financave, pozita e punës ‘‘ Zyrtar i Lartë i Listës së Pagave '' klasa Profesional 1, numri i kërkuar një (1) pozitë. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 25.03.2025 deri me 23.04.2025, e në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të nenit 39 paragrafi 12 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin është përcaktuar se:...12. *Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative..* si dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: Ankesa në procedurë pranimi. 1. *Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve dhe rrjedhimisht konstatoi se kandidati për pranim në Shërbim Civil, në rast të pakënaqësive me procesin e rekrutimit ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa, në rastin konkret ankesa është parashtruar me datë 21.05.2025, ende pa përfunduar procedura e pranimit sipas konkursit me numër të referencës RN00017348 gjegjësisht sipas përgjegjës në ankesë nga Thesari i Kosovës, del sipas Njoftimit i procesit të rekrutimit ka përfunduar pa fitues pa fitues, për pozitën ‘‘Zyrtar i Lartë i Listës së Pagave ’’, përmes Njoftimit me numër protokolli 429, me datën 27.05.2025, andaj sipas gjendjes faktike ankuesja ka parashtruar ankesë para afatit sipas dispozitave ligjore në fuqi, dhe si e tillë është e palejueshëm në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L 048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendoi si në dispozitivin e këtij vendimi

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendim

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr 929/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses Sh.K-I;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së